

VENDIM
Nr. 44, datë 30.1.2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 230, DATË 13.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGESË TË QIRASË TË DISA FAMILJEVE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT 'UNAZA E MADHE E TIRANËS, SEGMENTI KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pas lidhjes 2/2 shtohet lidhja 2/3 me listën emërore të subjekteve që do të trajtohen me qira, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Lista emërore sipas lidhjes 2/3 dhe lista emërore e familjeve që nuk janë paraqitur për tërheqjen e qirasë të verifikohen nga Enti Kombëtar i Banesave dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar, në bashkëpunim me njësinë administrative që mbulon zonën.

2. Në pikën 1, fjalët "... përfitojnë pagesën e qirasë për një periudhë dyvjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi." zëvendësohen me "...përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e plotë të qirasë, nga momenti i mbarimit të afatit të përcaktuar deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin.".

3. Pika 1/1 shfuqizohet.

4. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/2 e 1/3, me këtë përmbajtje:

"1/2. Financimi i qirasë për familjet përfituese të mbulohet 50% nga buxheti i shtetit, që akordohet për strehimin, 50% nga buxheti i Bashkisë Tiranë dhe zbatimi të bëhet nga Enti Kombëtar i Banesave. Për vitin 2018, familjet që kanë përfituar bonusin e qirasë nga Bashkia Tiranë përfitojnë vetëm diferencën ndërmjet qirasë së vlerësuar nga EKB-ja me shumën e bonusit që kanë përfituar nga Bashkia Tiranë.

1/3. Financimi i qirasë të bëhet pas verifikimit nga Bashkia Tiranë të gjendjes ekonomike dhe sociale të familjes, sipas parashikimeve të ligjit për strehimin.".

5. Pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

6. Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimi "Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit" zëvendësohet me fjalët "... ministria përgjegjëse për strehimin ...".

7. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, Enti Kombëtar i Banesave, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 2/3
LISTA EMËRORE E SUBJEKTEVE QË TRAJTOHEN ME QIRA

Subjektet që trajtohen me pagesën e qirasë, të cilat preken nga zbatimi i projektit të Unazës së Madhe të Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës	
1	Fatmir Ramazan Serjani
2	Hamdi Ibrahim Balla
3	Erald Kadri Ymeri
4	Besnik Kasem Peza
5	Lindita Sherifi
6	Elton Kruja
7	Mirela Ferhat
8	Skender Zeqiri
9	Vladimir Serjani
10	Lindita Mehmeti
11	Leme Balla

